

INTERVISTA/ Linda Vukaj, fituesja e çmimit ndërkombëtar "Gjon Mili", në një rrëfim për fotografimin

Mjafton pak për të qenë i lumtur

ALDA BARDHYLI

Fotografia është si zemra, ti e ndjen vetëm kur dikush e prek atë. Henri Cartier-Bresson vendoste gjithnjë dorën në krahora para se të merrte aparatin fotografik dhe të fokusonte në të ngjarjen që ishte para syve të tij. Linda Vukaj e sheh Bresson si artistin, arti i të cilit është një shkollë që të fton të vraposh drejt fotografisë. Vetëm një javë më parë Linda Vukaj, artistja nga qyteti i Durrësit që jeton në Parma të Italisë, u vlerësua me çmimin e parë në konkursin ndërkombëtar të fotografisë në Prishtinë "Gjon Mili", bashkë me artistin tjetër shqiptarë që jeton në Berlin, Mimoza Velu.

Por, para se të vlerësohej me këtë çmim, emri i Vukajit do të ngjalle kureshtje për median gjermane, pas ekspozitës që ajo hap në Berlin. Fotoja e saj, ku gjashtë murgësja kishin ngritur pak rrobën e gjatë për të lagur këmbët në ujin e detit në Kapri, do të ngjalle debate mbi erotikën që mbart. Por Vukaj e sheh këtë foto si një çast që tregon se "mjafton një moment për të qenë i lumtur".

Linda ka studiuar për Fizikë, një shkollë që e ka ndihmuar për të thelluar pasionin e saj të hershëm për fotografimin. Prej vitesh jeton në Parma të Italisë dhe thotë se jeta e saj është klasike, një punë, një familje ku e presin dy fëmijë dhe udhëtime. Këto të fundit janë mënyra që Linda ka zgjedhur për të zbuluar botën dhe bashkë me të njerëzit, që janë thelbi i kërkimit të saj artistik.

Jeni fituese e çmimit ndërkombëtar të fotografisë "Gjon Mili". Çfarë është për ju ky çmim dhe çfarë rrefen fotografia fituese?

Filimi i këtij çmimi për mua ka qenë një surprizë shumë e madhe dhe e mrekullueshme. Mendoj se çmimi "Gjon Mili" është me të vërtetë shumë i rëndësishëm dhe çdo vit tërheq vëmendjen e mjaft artistëve shqiptarë të shpërndarë në të gjithë botën. Ai më ka lejuar të balancohem me të gjithë artistët pjesëmarrës në këtë edicion.

Në të njëjtën kohë ai mban emrin e një fotografi të madh shqiptar, fatkeqësisht i panjohur dhe injoruar për shumë vite nga Shqipëria, por shumë i çmuar jashtë kufijve shqiptarë për kontributin, ndihmën e madhe që i ka dhënë botës së fotografisë si artist dhe si shkencëtar. Fotografitë e tij me ekspozim ultra të shkurtër përbejnë një nga dukuritë më interesante të lidhjes së shkencës me artin.

Ky çmim arrin në një moment shumë të veçantë të jetës sime artistike, pas një ekspozite personale në Berlin, që zgjati tre muaj, një ekspozitë kolektive së bashku me fotografe të tjera shqiptare që inaugurohet në fund të shtatorit në Nju Jork, një ekspozitë personale në Parma në fund të vitit dhe shumë projekte të tjera që kam në program të realizoj.

Dua të shotoj se jam mjaft e lumtur që çmimin e parë e kam ndarë me fotografan dhe shoqen time Mimoza Velu, që banon në Berlin, me të cilën ka lindur një bashkëpunim mjaft interesant në fushën artistike.

Shfrytëzoi rastin të falënderoj edhe shokun tim nga Prishtina, Shkumbin Saneja, i cili bëri të mundur pjesëmarrjen

time në konkurs, sepse pritoi dhe dorëzoi fotografitë për mua.

Fotografia fituese është një foto spontane e çastit e bërë në plazhin e Kaprit dhe rrefën harënë, lumturinë dhe bukurinë e jetës.

Në ekspozitën që ju hapët në Berlin disa javë më parë, mediat u ndalën të fotoja ku shfaqen disa murgësja që i lagin këmbët në det. Një foto ku nuk mungon erotika. Kur e keni realizuar atë?

Fotografinë me murgësat e kam realizuar shumë vjet më parë, në vitin 2000, në Kapri, Napoli, ku ndodhesha për të kaluar një fundjavë. Gjendesha në plazh në një ditë shumë të nxehtë, kur para meje u shfaq një pamje e mrekullueshme dhe surreale, në një dimension metafizik. Gjashtë murgësja që filluan të lagnin këmbët në breg të detit, për aq sa atyre mund t'u lejohet. Por gëzimi që transmetonin, të qeshurat dhe mrekullia e faktit që hynë dhe lageshin në ujin e freskët në një ditë shumë të nxehtë ishte diçka e papërshtueshme.

Unë shkrepja disa fotografi në ato çaste. Njëra prej tyre është fituesja e çmimit të parë. Besor se nëpërmjet kësaj fotografie kam mundur të transmetoj një moment mjaft të lumtur, mrekullinë e jetës, ku mjafton shumë pak për t'u ndjerë i lumtur. Mendoj se juria e konkursit, ndër të tjera, e ka vlerësuar në veçanti këtë aspekt njerëzor që transmeton kjo fotografi.

Çfarë është femra në fotografinë tuaj?

Në të vërtetë, në fotografimin time më intereson në përgjithësi aspekti njerëzor, ku femra nuk ka një vend të privilegjuar. Por në shumë fotografi të mia, ajo zë një vend të rëndësishëm. Herë shfaqet si një mbartëse e familjes, me fëmijët e ngarkuar në shpinë, me veshjet tradicionale si mbartëse të civilizimit dhe identitetit, herë shfaqet në një muze e përqendruar të analizojë artin, apo brenda familjes, krenare për mrekullinë e jetës që ka mundur të krijojë. Ndonjëherë shfaqet si mbartëse e një jete që tashmë ka lënë shenjat dhe i

janë rritur në mënyrë eksponenciale këto kohët e fundit. Komunitetet e fotografëve në internet si Flickr, apo Facebook më kanë dhënë mundësi të njoh më mënyrë virtuale shumë artistë shqiptarë të shpërndarë në të gjitha anët e botës dhe të bashkëpunoj me ata e të shkëmbej mjaft pikëpamje nga ana artistike dhe njerëzore.

Të gjitha distancat gjeografike që ishin dhe vazhdojnë të jenë një pengesë për t'u takuar fizikisht, interneti i ka shkuratur dhe kjo është diçka fantastike. Jam shumë krenare kur dëgjoj për sukseset e artistëve shqiptarë si në Itali, ku jetoj, ashtu edhe në shtete të tjera.

Duket se në foto ju pëlqen më shumë të fokusoni personazhe. Doja të ndalesha te një cikël i tërë që ju u keni kushtuar portreteve. Çfarë mbart portreti sipas jush?

Njeriu e ka tërhequr gjithnjë vëmendjen time, kështu që personazhet rrotullohen gjithmonë rreth aksit qendror të fotografive që kam realizuar deri tani. Portreti është për mua një radhë të parë realizimi, stabilizimi i një kontakti psikologjik me personin që dua të fotografoj. Nuk ka rëndësi nëse këtë person e njoh mirë dhe nga shumë kohë, apo nëse vështrimi im sapo është ndalur tek ai për herë të parë. Nëse kjo ndodh alkimi psikologjike për mua është e pamundur të rezistoj dhe të mos i kërkoj këtij personi nëse mund t'i realizoj një portret. Fatkeqësisht jo gjithnjë është e mundur...

Keni bërë një reportazh mbi Verdin. Mund të na flisni pak mbi këtë hulumtim?

Reportazhi është një veprim progresiv i mendjes, ka përkulur, por vetëm fizikisht. Ju keni studiuar për Fizikë dhe tashmë bëni jetën e një artisteje. Si ndodhi?

Në të vërtetë shumë herë më pyesin se si ndodhi ky kalim nga fizika te fotografia. Mendoj se formimi im fizik dhe matematik më ka ndihmuar mjaft në pasionin tim për fotografimin, si nga ana teknike, ashtu edhe nga ana e kompozimit të fotografisë. Pasioni i fotografisë ka shumë vjet që ka lindur dhe udhëton në paralele me pasionin tim për shkencat dhe aktualisht me punën time si menaxhere projektsh për internet. Është një pasion i lidhur me ambientin artistik që më rrethon në familje dhe që ka ndikuar në një farë mënyre edhe në rrugën që kam zgjedhur si fotografe. Në të vërtetë bëj një jetë "klasike", kam një punë që më pëlqen shumë, një familje që e adhuroj dhe në mbrëmje të gjithë së bashku në shtëpi. Por kam fatin që mund të udhëtoj shpesh dhe t'u dedikoj shumë udhëtime projekteve të mia, ku të mund të shpreh nëpërmjet aparatit fotografik atë që më shumë më prek direkt në zemër dhe transmeton emocione. Sigurisht shpesh këto emocione nuk ka nevojë t'i kërkoj larg, i gjej brenda familjes sime, siç flasin edhe mjaft nga fotografitë që u kam dedikuar. Mendoj se në këtë moment kam një ekuilibër perfekt dhe ndihem e realizuar si artiste, si femër dhe si nënë.

Çfarë është fotografia për ju?

Fotografia është një pjesë përbërëse e jetës sime, është një emocion, një ndjenjë. Ajo më jep mundësinë që të ngrihem në një moment nëpërmjet syrit dhe ndjeshmërisë sime të momentit, të shkrep aparatit dhe të transmetoj mënyrën se si e shikoj unë jetën. Dhe fakti që mënyrën time të të shikuarit të jetës mund ta ndaj me personat tjerë me emocionon çdo herë që shkrep një fotografi.

Çfarë mendoni për artin e fotografisë që bëhet sot në hapësirat shqiptare?

Kontaktet me fotografitë shqiptarë



FOTOGRAFIA ËSHTË NJË PJESË PËRBËRËSE E JETËS SIME, ËSHTË NJË EMOCION, NJË NDJENJË. AJO MË JEP MUNDËSINË QË TË NGRIJË NJË MOMENT NËPËRMJET SYRIT DHE NDJESHMËRISË SIME TË MOMENTIT, TË SHKREP APARATIN DHE TË TRANSMETOJ MËNYRËN SE SI E SHIKOJ UNË JETËN. DHE FAKTI QË MËNYRËN TIME TË TË SHIKUARIT TË JETËS MUND TA NDAJ ME PERSONA TË TJERË ME EMOCIONON ÇDO HERË QË MENDOJ DHE MË MBUSH ME DËSHIRË SA HERË QË SHKREP NJË FOTOGRAFI